



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3, të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenin 5 paragrafi 1.3 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Procedurën e Zëvendësimit të Anëtarit të Kuvendit Komunal, nenin 17 të Ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 28.03.2019 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **ZNJ. RUKIJE KRASNIQI** emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Rahovec, nga subjekti politik "Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës- AAK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal znj. Florije Boshnjaku.
- II. Obligohet Kryesuesi i Kuvendit Komunal në Rahovec, që ky vendim t'i komunikohet znj. Rukije Krasniqi, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 26.12.2018, Nr. 837/2018, për zëvendësimin e anëtares të Kuvendit znj. Florije Boshnjaku, pas dorëheqjes së saj, për arsyeje të marrjes së pozitës së re në shërbimin civil.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirenditur, e cila është, znj. Rukije Krasniqi nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

IV.

Prishtinë, 28.03.2019

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka